



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 14

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 26 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5734, datë 21.3.2018	Për shitje me ankand të objektit në pronësi të Bashkisë Durrës..... 3



NJOFTIM
Nr. 5734, datë 21.3.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË OBJEKTIT NË
PRONËSI TË BASHKISË DURRËS**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike,

Në pronësi të Bashkisë Durrës

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (mjete kryesore + mjete xhiroje)	Mjetet kryesore (objekti)	Mjetet e xhiros	Trualli		
1	Kapanone të ndërmarrjes “Parku i mallrave të eksportit”	Shkozet, Durrës	27 123 215.9	27 123 215.9	0	37 660 660	3 197	2 063

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratën noteriale në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se,

Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

6. Marrëveshjen e dokumentuar midis trashëgimtarëve të ish-pronarit Osman Dino dhe të pronarit Arben Ferhati për privatizimin e objektit në bashkëpronësi.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim. Publikimi bëhet për ish-pronarin e truallit Osman Dino (trashëgimtarët e tij) dhe pronarin Arben Ferhati.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.